

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, koleji i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Nebojsa Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve M. H. dhe A. S. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par. 1 lidhur me par. 3 e lidhur me nenin 23 të KPK-së, M. H., A. S., M. Gj., Z. V. dhe V. H., për shkak të veprës penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së, ndërsa V. H. edhe për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 348 par. 1 të KPK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga Prokurori i Shtetit të Kosovës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – Departamenti për krime të rënda Pejë, P.nr.90/2013 datë 28.1.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR nr.241/2015 datë 11.9.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30 mars 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar nga Prokurori i Shtetit të Kosovës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – Departamenti për krime të rënda Pejë, P.nr.90/2013 datë 28.1.2015 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR nr.241/2015 datë 11.9.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore – Departamenti për krime të rënda Pejë, P.nr.90/2013 datë 28.1.2015 i dënuari V. H. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit zyrtar nga neni 348 par. 1 të KPK dhe për këtë veper i është shqiptuar dënim me kusht ashtu që i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë)

muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet poqë se i dënuari në afat prej 1 (një) viti nuk do të kryen veprë të re penale. I është shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i indeksit me nr. dosja lëshuar në emër të V. B. nga UP Administrata Qendrore në Prishtinë datë 27.7.2006. Është detyruar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 €. Me të njëjtin aktgjykim të pandehurit M. H. dhe A. S. në kuptim të dispozitës së nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së janë liruar nga akuza për shkak të veprës penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par. 1 lidhur me par. 3 e lidhur me nenin 23 të KPK-së, ndërsa sipas pikës 3 të dispozitivit të pandehurit M. H., A. S., M. Gj., Z. V. dhe V. H., në pajtim me dispozitën e nenit 364 par. 1 pika 1.3. të KPPK-së, janë liruar nga akuza për shkak të veprës penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së. Është vendosur që në këtë pjesë shpenzimet e procedurës penale të binë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës ndërsa pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.241/2015 datë 11.9.2015.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit penal me propozim që kërkesa të aprovohet dhe të konstatohet shkelja e Ligjit në favor të pandehurve.

Të pandehurit e as mbrojtësit e tyre nuk kanë dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e çështjes, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në pajtim me dispozitën e nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK-së.

Në kërkesë Prokurori i Shtetit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 370 par. 7 të KPPK-së e cila shkelje konsiston në atë se arsyetimet e të dy aktgjykimeve janë në kundërshtim me njëra tjetrën mirëpo nuk precizohet se ku qëndrojnë këto kundërshtime. Kështu, sipas thënieve në kërkesë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është konstatuar “Prokurori i Shtetit ka dështuar të sigurojë provat për shumën e saktë të të hollave të inkasuara në shkollë e që është bazë për

cilësimin e veprës penale për të cilën i akuzon të akuzuarit “, ndërsa nga ana tjetër nga ekspertiza financiare të ekspertit e cila është administruar si provë rezulton se kostoja e studimeve për një student ka qenë 487 € dhe gjatë periudhës prej 1999 deri 2010 studimet kanë vijuar 3654 studentë dhe të hyrat nga ky numër është dashur të jenë 983.148,00 €. Në mbështetje të këtij fakti flet edhe eksperti financiar se në regjistrat e Fakultetit të Shkencave Aplikative të biznesit në Pejë nuk përmbajnë firmosje apo vula të cilat mund të konfirmohen si dëshmi zyrtare, nuk është përfshirë arsyeshmëria e pagesave, numri personal i indeksit, semestri, paraqitja e provimeve dhe emri i bankës si elemente të detyrueshme të raportimit të pasqyrave financiare në baza periodike apo vjetore. Ndërsa sa i përket “fletores së gjelbërt” e cila është konfiskuar nga i pandehuri V. H. dhe në të cilën figurojnë 505 studentë të regjistruar jashtë konkursit dhe me urdhër të zyrtarëve të këtij Fakulteti prova këto që vërtetojnë kryerjen e veprës penale. Në kërkesë po ashtu potencohet se kundërthënie tjetër në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është fakti se kjo Gjykatë ekspertizën financiare të ekspertit E. G. e vlerëson si jo të bindshme me arsyetim se kosto e studimeve për një student eksperti ka llogaritur sipas një mesatareje për çka nuk i fali besimin, mirëpo nga ana tjetër kjo Gjykatë ia falë besimin dëshmitarit M. G., i cili ka deklaruar se nuk ka mundur t’ia sigurojë të gjitha të dhënat financiare ekspertit pasi që në vitin 2010 për shkak të zjarrit që ka përfshirë vendin e tij të punës janë djegur shumica e dokumentacionit që kanë të bëjnë me pagesat dhe regjistrat. Në vazhdim Prokurori thekson se lidhur me veprën penale të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare, ekzistimi i kësaj vepre konsiston në mos raportimin e të hyrave të Fakultetit në pasqyrat financiare gjë që sipas Statutit të Fakultetit është përgjegjësi e dekanit, ndërsa sa i përket shumës së të hollave prej 10.000 €, e njëjta është marrë pa bazë ligjore sepse nuk është dëshmuar ekzistimi i dosjeve të përtëritura. Prandaj, theksohet se shkeljet këto kanë rezultuar me shkeljen e Ligjit penal sepse në veprimet e të pandehurve përmbushen të gjitha elementet e veprës penale për të cilat janë akuzuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë nga këto arsye:

Aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse fjalët e cituara në kërkesë, në asnjë mënyrë nuk mund të merret si kundërthënie me ekspertizën financiare, për faktin ky është konstatimi i gjykatës si rrjedhojë i

vlerësimit të provave të administruara në shqyrtim gjyqësor. As pretendimi se aktgjykimi është në kundërshtim me përmbajtjen e shkresave të çështjes nuk qëndron sepse Prokurori i Shtetit, në kërkesën e tij vetëm e bënë komentimin e ekspertizës financiare duke mos precizuar se në çfarë manifestohen kundërthëniet e pretenduara. Përkundrazi, aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të qartë dhe konkret nuk ka kundërthëniet me vetveten dhe arsyetimin e as që ka kundërthënie me përmbajtjen e shkresave të çështjes.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes, gjykata e shkallës së parë vendimin e vet e bazon në provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, në mbrojtjen e të pandehurve, deponimin e dëshmitarit M. G., ekspertizën financiare të ekspertit E. G., si dhe prova tjera materiale.

Në këtë çështje penale nuk kanë qenë kontestuese këto fakte: se dekani i fakultetit ka qenë i pandehuri A. S., i cili më 7.12.2006 është pensionuar, M. H. ka qenë sekretar i fakultetit dhe është pensionuar në vitin 2008, M. Gj. ka qenë asistente e dekanit, Z. V., referente për regjistrimin e studentëve, paraqitjen e provimeve, formulimin e listës për provime dhe është pensionuar në vitin 2008, ndërsa V. H. ishte arkëtar i fakultetit. Po ashtu, nuk është kontestues as fakti se periudha inkriminuese sipas aktakuzës dhe dispozitivit II për veprën penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par. 1 lidhur me par. 3 e lidhur me nenin 23 të KPK ka qenë 14.11.2006 kurse ajo për veprën penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së ka qenë periudha e vitit 1999 deri me 31.12.2010. Po ashtu nuk ia qenë kontestues fakti se sipas vendimit 01.nr. 378/1999 datë 03.09.1999 të UP Shkolla e Lartë Ekonomike Pejë të nënshkruar nga drejtori i shkollës në këtë kohë i pandehuri Dr. A. S., në bazë të nenit 172 të Ligjit të procedurës administrative, është vendosur për ripërtëritjen e dosjeve të zhdukura gjatë luftës dhe formimin e komisionit për këtë qëllim, kurse me aktvendimin e datës 14.11.2006 nga Dekani i fakultetit në Pejë i pandehuri A. S., është lejuar pagesa për anëtarët e komisionit për ripërtëritjen e 230 dosjeve për çfarë janë siguruar mjete në shumë prej 10,00 € ndërsa është bërë pagesa nga 300 € për secilin anëtar të komisionit.

Eksperti financiar E. G., ne raportin e tij të paraqitur në formë të shkruar 18 maj 2011 në pjesën e parë të ekspertizës konstaton se në mesin e materialeve për ekspertizë ishin regjistrat e ofruara nga Prokurori i Shtetit, të cilat nga eksperti janë trajtuar si dëshmi të pamjaftueshme apo pa kompetencë nga institucioni arsimor nga se materia e ofruar nuk ka asnjë firmosje apo vulosje

që i konfirmon si dëshmi zyrtare. Në të njëjtin raport, eksperti konstaton se vlera e të hyrave nga pagesat e shërbimeve për student të cilit kanë vijuar studimet prej vitit 1999 deri në vitin 2009 dhe atë që janë regjistruar para viteve 1999 por që kanë diplomuar në vitin 2007 në FSHAB në Pejë, duhet të jetë aproksimalisht-përafërsisht 1.537.783,00 €. Nga përpunimi i raporteve bankare janë nxjerr të dhëna se janë paguar nga viti 2002 deri më 2010 në emër të shërbimeve të studentëve për studime gjithsej 554.635,00 € ose më pak se sa është dashur të paguhen sipas rregulloreve tarifore dhe vendimeve për shumën prej 983.148,00 €. Në shqyrtimin gjyqësor më datë 07.05.2014 , duke dhënë sqarime rreth mendimit të dhënë me shkrim, eksperti E. G., ka precizuar “ fillimisht jemi shërbye me dokumentacionin të cilin e ka ofruar prokurorja Sahide Gashi, nga ai dokumentacion kemi trajtuar si hap i parë në procedurë të mëtutjeshme të ekspertizës. Kemi vlerësuar që dokumentacioni si i tillë nuk është i mjaftueshëm që të trajtohet për të dhënë një vendim prej ekspertizës”.Më pas duke sqaruar çështjen e dokumentacionit, eksperti e potencon përsëri faktin se dokumentacioni ishte i pamjaftueshëm dhe jo shumë i besueshëm nga të gjitha nivelet si i kanë ofruar si të tillë dhe mosgatishmëria e tyre e sidomos Fakultetit të Shkencave Aplikative dhe qendra në Prishtinë si dhe sistemi i mangët bankar aspak informativ, të gjitha këto kanë krijuar vështirësi dhe një kompleksitet që mund të jepet një konkluzion i qëndrueshëm dhe profesional lidhur me numrin e studentëve prej 3654. Kjo listë është ndërtuar nga pasqyrimi sipas emrave dhe elementeve të numrit të amzës, pagesave të vitit të diplomimit të shfrytëzuesve të shërbimeve. Kostoja prej 487 është një mesatare e duke pasur parasysh pagesën e semestrit, paraqitjen e provimeve deri tek taksa e diplomimit, parametra këto për ndërtimin e kostos e cila sipas përfundimit do të duhej të paguheshin 983.148,00 €”.

Prandaj, duke i pasur parasysh të cekurat si dhe faktin e pakontestueshëm se në vitin 2010 pas shpërthimit të zjarrit në Fakultet, është asgjësuar e tërë arkiva-dokumentacioni i Fakultetit, rezultojnë të drejta konkludimet e gjykatës së shkallës së parë të cilat i ka konfirmuar edhe ajo e shkallës së dytë se në rastin konkret nuk është provuar se të pandehurit kanë kryer vepra penale për të cilat janë akuzuar. Në prani të një gjendjeje të tillë faktike, drejt ka vepruar gjykata e shkallës së parë kur ekspertizës nuk i ka falur besimin meqenëse mungesa e përcaktuar nga eksperti në emër të regjistrimit të studentëve si dhe shuma prej 10,00 €, nuk është justifikuar me prova konkrete, të cilat do të tregonin gjenezën e kësaj mungese apo përvetësimin e të hollave gjatë ushtrimit të detyrës, gjë që edhe vet eksperti ka pohuar në sqarimet e dhëna në ekspertizën e paraqitur me shkrim por edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Nga arsyet e lartë cekura kjo Gjykatë refuzoi si të pabazuar kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligshmërisë dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr.27/2016 datë 30 mars 2016

Procesmbajtëse,
Minire Xhambazi

Kryetar i kolegjit,
Avdi Dinaj